



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 927/4 prot.

Tiranë më 15. 9.2017

URDHËR

Nr. 235, datë 15. 9.2017

PËR
SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE, TË CILAT KANË
TEJKALUAR AFATIN LIGJOR TË PËRPUNIMIT

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 29 dhe 30 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.162, datë 15.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Fondacioni "Joshua Center" Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.162, datë 15.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, është institucion rezidencial, misioni i të cilit ka për qëllim të ofrojë nëpërmjet shërbimeve, ndërhyrjes dhe trajtimeve të ndryshme, një komoditet për të moshuarit vulnerabël dhe ata me sëmundje mendore jo agresive.

Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, ka status juridik "Organizatë jo fitimprurëse" dhe me NIPT:K51428013Q.

Ky kontrollues mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale të kategorive "punëmarrës" dhe "rezidentë".

Gjatë ushtrimit të detyrës, ky kontrollues mbledh të dhëna personale, si gjeneralitete dhe më së shumti të dhëna personale sensitive, duke filluar që nga formulari fillestar i pranimit, duke vazhduar me një sërë vlerësimesh mbi gjendjen e rezidentit si: vlerësimin shëndetësor.

vlerësimin familjar, vlerësimin psiko-social, vlerësimin financiar, vlerësimin e nevojave arsimore profesionale, etj.

Një nga parimet bazë të aktivitetit të kontrolluesit është konfidencialiteti, por ky parim mbetet i pa materializuar në akte të brendshme të kontrolluesit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi Fondacioni “Joshua Center” Tiranë, ka kryer detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.
2. Kontrolluesi Fondacioni “Joshua Center” Tiranë, nuk ka një rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Konstatimi i pikës 2, përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, – “1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera”.

3. Kontrolluesi Fondacioni “Joshua Center” Tiranë, nuk aplikon me punëmarrësit Deklaratën e Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit ku parashikohen: **Objekti, qëllimi, fusha e veprimit, masat për shpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimin e punëdhënësit.** Gjithashtu, kjo deklaratë merr fuqi provuese dhe ligjore nga nënshkrimi (emri dhe firma) i punëdhënësit, kriter i detyrueshëm i kësaj deklaratë.

Konstatimi i pikës 3 të këtij procesverbali, përbën shkelje administrative të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, - “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.

4. Kontrolluesi Fondacioni “Joshua Center” Tiranë, mbledh të dhëna personale sensitive “besimi fetar e filozofik” dhe “etnia”, të dhëna të cilat, në këndvështrimin e grupit të kontrollit janë të tepërta dhe tejkalojnë qëllimin e përpunimit.

Konstatimi i pikës 4 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 5 germa “c” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar:

“1. Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;”.

Gjatë hetimit administrativ konsatohet mbajtja e dosjeve me të dhëna personale sensitive të kategorisë “rezidentë”, më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Këto dosje, përmbajnë të dhëna sensitive me karakter vetjak dhe cenojnë jetën private dhe familjare të tyre.

Zyra e Komisionerit pas përfundimit të procedurës së kontrollit ka dalë me aktin rekomandues, Nr.33, datë 24.07.2017, në lidhje me shkeljet e konstatuara sipas pikave të procesverbalit të mësipërm, ku ndër të tjera shprehet:

“Në zbatim të nenit 5, germa “d” të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, i cili shprehet:

“1.Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”, kontrolluesi Fondacioni “Joshua Center” Tiranë, të rishikojë gamën e të dhënave që mbledh, duke patur parasysh, mjaftueshmërinë e tyre, si dhe mos tejkalimin e qëllimit për të cilat janë mbledhur dhe përpunohen këto të dhëna.

Neni 3 “Përkufizime”, pika 4 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përcakton se:

“Të dhëna sensitive” është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale”.

Në konsultimet paraprake që Zyra e Komisionerit ka zhvilluar me palët e interesuara, është konkluduar se afati i mbajtjes së dosjeve të “rezidentëve” nuk duhet të jetë më shumë se 10 vjet nga dalja e “rezidentëve” prej qendrës. Duhet patur parasysh fakti se, rezidentët vërtet janë të moshuar, por në dosjet e tyre ka të dhëna për familjarët e tyre, marrëdhëniet me ta, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, sidomos kur është fjala për të dhënat sensitive të individëve, përpunimi i paligjshëm i të cilave sjell pasoja të pariparueshme të jetës dhe privatësisë së tyre. Të dhënat personale sensitive, marrin një rëndësi akoma më të madhe me hyrjen në fuqi në vitin 2018, të Rregullores së BE-së 2016/679 dhe Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 27 prill 2016 “Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”.

Subjekti i të dhënave sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, ka të drejtën ti kërkojë kontrolluesit të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, në mënyrë të menjëhershme.

Neni 30, paragrafi 1, germa “b” e ligjit të sipërcituar përcakton se:

"Komisioneri ka këto të drejta:

b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale".

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 7, 29, 30 pika 1, germa "b" dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, pezullimin e përpunimit të të dhënave personale sensitive (dosjet) e subjekteve të të dhënave, kategoria "rezidentë", që kanë mbi 10 vjet nga përfundimi i qëllimit për të cilin janë mbledhur.
2. Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, të parashikojë në rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale", afatin 10 vjeçar të mbajtjes së dosjeve të "përfitueseve", pas daljes së tyre nga qendra përkatëse.
3. Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, të realizojë seleksionimin e dosjeve që disponon, deri në klasifikimin dhe verifikimin e saktë të tyre si:
 - a. Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në përputhje me afatet ligjore.
 - b. **Të dhëna personale sensitive (dosje) të ruajtura në shkelje të afateve ligjore.**
4. Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, pasi të ketë vepruar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij urdhëri, brenda një periudhe 60 (gjashtëdhjetë) ditore të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale sensitive (dosje) të arkivuara në kundërshtim me afatet ligjore.
5. Kontrolluesi Fondacioni "Joshua Center" Tiranë, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 60 ditëve.
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më, 15/3 /2017

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

